



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo			
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës			
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova			
Civil Aviation Authority of Kosovo			
CAA			
Nr. i prot.	2022/ZDP/290		
Br. prot./Prot. Nr.			
Faqe:	Kopje:	Datë:	
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date	
Hyrës/ulazno/in	<input type="checkbox"/>		
Dalës/izlazo/out	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brandshëm/vitemo/intemal	<input type="checkbox"/>		
Prishtinë/Prishtina/Pristina			

08/ZDP/VE/2022

Datë: 22.09.2022

Në mbështetje të nenit 21 paragrafit 2, nenit 23 paragrafit 1, nenit 36 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, nenit 36 paragrafit 1 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr:

VENDIM

1. CAKTOHET Komisioni për shqyrtimin e të gjitha kërkesave që kanë të bëjnë me aprovimin dhe lëshimin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ajror të pranuar në AAC, me përbërje në vijim:
 - a) Z. Matej Krasniqi, Inspektor i Vlefshmërisë Ajrore – Kryesues;
 - b) Z. Nexhat Bala, zyrtar në Departamentin e Aviacionit Civil - Anëtar dhe
 - c) Z. Alban Thaqi, Zyrtarë për Shpenzime dhe Administratë - Anëtar.
2. Obligohen anëtarët e Komisionit që t'i shqyrtojnë kërkesat në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, me ndryshime, dhe aktet tjera nënligjore në fuqi për aprovim dhe lëshim të licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ajror në vend.
3. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi ka mandat 6 muaj, nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, i publikuar në Gazetën Zyrtarë të Republikës së Kosovës më 05 shtator 2022, ka implikuar ndryshimin dhe bartjen e përgjegjësi në fushën e lëshimit të licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ajror, nga Ministria

përgjegjëse për transport tek Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-063, AAC ka filluar të pranoj një numër të kërkesave nga operatorë ajrorë që kanë të bëjnë me ekonominë e transportit ajror, të cilat çështje paraprakisht janë trajtuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Pas korrespondencave elektronike të datës 20 shtator 2022 dhe 21 shtator 2022 në mes të AAC-së dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe takimit të datës 21 shtator 2022, si pjesë e bashkëpunimit dhe koordinimit të transferit dhe përgjegjësive në mes të dy institucioneve, palët u dakorduan që AAC të krijoj një Komision të përbashkët për shqyrtimin e kërkesave të lartpërmendura, me përbërje të dy anëtarëve nga AAC dhe një nga Ministria.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, pas dakordimit me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe në pajtim me nenin 21 paragrafin 2, nenin 23 paragrafit 1, të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, me ndryshime, nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenin 26 të Ligjit Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të ngrisin konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

për: **Bujar Ejupi**
Drejtor i Përgjithshëm



Iu dërgohet: Anëtarëve të Komisionit;
Zv. Sekretarit të Përgjithshëm MMPHI;
Arkivit të AAC-së; dhe
Arkivit të MMPHI.